



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 154

Tiranë – E premte, 15 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 13.11.2019	Për një shtesë të fondeve buxhetore për institucionet e sistemit të drejtësisë, për vitin 2019..... 12565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 13.11.2019	Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës, për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë..... 12565
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 267, datë 24.7.2019	Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese 12567
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 355, datë 16.10.2019	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”..... 12592
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 582, datë 12.11.2019	Për delegimin e kompetencave..... 12592
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6357/4, datë 28.10.2019	Për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajgurore..... 12592

**VENDIM**

Nr. 730, datë 13.11.2019

**PËR NJË SHITESË TË FONDEVE
BUXHETORE PËR INSTITUCIONET E
SISTEMIT TË DREJTËSISË,
PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucioneve të sistemit të drejtësisë, në grupin buxhetor nr. 63, në shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin e vitit 2019, i shtohet fondi i përgjithshëm prej 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh, i detajuar në programet buxhetore, si më poshtë vijon:

- a) 9 000 000 (nëntë milionë) lekë në programin “Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit”;
- b) 2 000 000 (dy milionë) lekë në programin “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar”;
- c) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë në programin “Veprimtaria e Komisionerit Publik”.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të vendimit, të përballohet nga fondi rezervë i institucioneve të sistemit të drejtësisë për vitin 2019.

3. Ngarkohen Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisionerët Publikë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 732, datë 13.11.2019

**PËR RREGULLAT PËR KOHËZGJATJEN
E PUNËS, DITËT PUSHIM DHE LEJEN,
ORËT JASHTË ORARIT DHE
SHPËRBLIMIN E TYRE, SI DHE
KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE PËR
KRYERJEN E DETYRËS JASHTË
VENDIT TË PUNËS, PËR NËPUNËSIT
CIVILË GJYQËSORË DHE TË
PROKURORISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 84, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 76–108, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. KOHËZGJATJA E PUNËS**

1. Kohëzgjatja javore e punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë është 40 orë në javë.

2. Orari ditor i punës fillon çdo ditë në orën 8.00 dhe përfundon në orën 16.00.

3. Për efekt të llogaritjes së pagës orare muaji llogaritet, mesatarisht, me 174 orë pune.

4. Në raste të veçanta dhe për arsye objektive, orari ditor i punës mund të ndryshohet me urdhër të kryetarit të gjykatës ose drejtuesit të prokurorisë përkatëse, por jo për një periudhë më të gjatë se 3 muaj.

5. Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e kryetarit të gjykatës ose drejtuesit të prokurorisë, nëpunësit mund t’i kërkohej të kryejë orë shtesë.

Nëpunësit, që kryen orë shtesë në punë, i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.



Në raste të veçanta, kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë ka të drejtë të kompensohet financiarisht. Mënyra e kompensimit bëhet sipas legjislacionit në fuqi nga këshillat përkatës, pasi të jetë konsultuar më parë me ministrinë përgjegjëse për financat.

6. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë mund të kryejë veprimtari mësimdhënieje pas miratimit nga kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompensohen në orë pune, brenda javës, pas orarit zyrtar të punës. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë, që angazhohet në mësimdhënie, detyrohet të depozitojë pranë kancelarit kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.

II. PUSHIMET

1. Ditët e shtunë dhe e diel janë ditë pushimi javor.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 javë kalendarike. Koha e kryerjes së lejes së pushimit vjetor përcaktohet nga kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, sipas kërkesës së nëpunësit civil gjyqësor ose të prokurorisë, duke mos cenuar vijueshmërinë e punës. Nëpunësi civil gjyqësor ose i prokurorisë ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor edhe në periudha të ndryshme e të ndara, por këto periudha nuk mund të jenë më të shkurtra se 6 ditë në vijim. Në qoftë se pushimi vjetor nuk kryhet brenda vitit kalendarik përkatës, ai mund të kryhet deri në tremujorin e parë të vitit kalendarik pasardhës.

Ditët e festave zyrtare nuk përfshihen në pushimet vjetore të paguara. Nëse nëpunësit dita e festës i bie në periudhën e pushimeve vjetore të paguara, këto të fundit i shtyhen për aq ditë sa ka qenë festa zyrtare.

3. Pushimet vjetore nuk kompensohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme.

4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar, kur nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve juridike të punës.

5. Pushimi vjetor i paguar, që i është dhënë nëpunësit civil gjyqësor dhe të prokurorisë në një vend tjetër pune, llogaritet në kohën e pushimit vjetor të paguar, kur ai caktohet në një vend tjetër pune.

6. Kur marrëdhëniet juridike në shërbimin civil gjyqësor dhe të prokurorisë apo të punës kanë përfunduar dhe nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë nuk ka kryer pushimin vjetor të paguar, ai përfiton një shpërblim në masën e pagës përkatëse.

7. Paga e dhënë për pushimin vjetor të paguar është ajo që ka përfituesi në çastin e marrjes së saj dhe i jepet atij në fillim të pushimit vjetor.

8. Kur nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë, për arsye shëndetësore, bëhet i paafte për punë gjatë periudhës së kryerjes së pushimit vjetor të paguar dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, njofton kancelarin dhe strukturën që kujdeset për mbarëvajtjet e çështjeve të personelit dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

9. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet, si më poshtë vijon:

- a) Martesën e nëpunësit civil 5 ditë;
- b) Martesën e fëmijës së tij 3 ditë;
- c) Lindjen e fëmijës për baballarët 3 ditë;
- ç) Vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortit, të fëmijës, të vëllezërve, të motrave 5 ditë;
- d) Ndërrimin e banesës 2 ditë;
- dh) Sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve apo bashkëshortit, të vërtetuara me raport mjekësor 5 ditë;
- e) Përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve pasuniversitarë, për punën që kryejnë 10 ditë.

10. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë ka të drejtë, që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin apo prindërit. Kohëzgjatja e kësaj lejeje përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, me propozimin e eprorit të drejtpërdrejtë. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.

III. PUNA NË DITËT E FESTAVE ZYRTARE DHE TË PUSHIMIT JAVOR

1. Si rregull, ditët e festave zyrtare janë ditë pushimi. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë gëzon të drejtën e pagës në këto ditë.



2. Kur festa zyrtare bie në ditët e punës dhe me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive është vendosur të punohet, puna e kryer ditën e festës zyrtare kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 për qind ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e ditës së punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.

3. Kur festa zyrtare bie në ditët e pushimit javor, dita e hënë është ditë pushimi.

4. Pushimi vjetor i paguar, pushimet e tjera dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të nëpunësit civil.

IV. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE PËR KRYERJEN E DETYRËS JASHTË VENDIT TË PUNËS

1. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë i cili gjatë ditëve zyrtare të punës shkon me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohet financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit.

2. Nëpunësi civil gjyqësor dhe i prokurorisë i cili dërgohet me shërbim jashtë vendit, për të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme ndërkombëtare, trajtohet financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxhetet e miratuara për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, gjykatat dhe prokuroritë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR

Nr. 267, date 24.7.2019

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e kategorizimit të strukturave akomoduese, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e formatit dhe të modelit të certifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Çdo subjekt që do të ushtrojë veprimtarinë, si strukturë akomoduese, është i detyruar brenda 30 ditëve nga regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, të pajiset me certifikatën e kategorizimit.

4. Çdo subjekt që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese është i detyruar të aplikojë për marrjen e certifikatës së kategorizimit, brenda datës 31.10.2019, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese.

5. Ngarkohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike dhe inspektorati përgjegjës për turizmin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi



RREGULLORE
PËR MËNYRËN, KRITERET DHE
PROCEDURËN PËR KATEGORIZIMIN E
STRUKTURAVE AKOMODUESE

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës, kriterëve dhe procedurës për kategorizimin e strukturave akomoduese, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar.

Neni 2

Kriteret

1. Çdo subjekt duhet të plotësojë kriteret e detyrueshme për nivelin më të ulët të sistemit të klasifikimit, të kategorisë për të cilën aplikon, të përcaktuar në VKM-në nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, sipas modelit, shtojca 4, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

2. Çdo subjekt që do të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet të pajiset me certifikatën e kategorizimit, brenda 30 ditëve nga regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Çdo subjekt, që aktualisht ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet t’i nënshtrohet procedurës për kategorizimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të urdhrit të ministrit, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 3

Kategoritë e strukturave akomoduese të
ndara në klasat e Nomenklaturës së
Veprimtarive Ekonomike (NVE)

Strukturat akomoduese, sikurse përcaktohen në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, përfshijnë kategoritë:

a) “Bujtinë”; b) “Fjetinë” (hostel); c) “Kamping”; ç) “Hotel”; d) “Motel”; dh) “Resort”; e) “Qendër kurative”; ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B), të cilat, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 28.5.2014, “Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2)”, grupohen në katër klasa të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE), sipas tabelës më poshtë:

Klasa	Përshkrimi i klasës	Kategoritë e strukturave akomoduese
5510	Hotele dhe struktura të ngjashme	Hotel, resort, qendër kurative
5520	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	Motel, fjetinë (hostel)
5530	Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	Kamping
5590	Akomodime të tjera	Fjetje dhe mëngjes (B&B), bujtinë

Neni 4

Procedura e kategorizimit të strukturave
akomoduese

1. Procedura e kategorizimit të strukturave akomoduese u nënshtrohet tri fazave:

a) faza e parë përfshin procesin e vetëdeklarimit të sipërmarrësit turistik, i cili konsiston në plotësimin e formularit të vetëdeklarimit dhe dorëzimit të dokumentacionit shoqërues, të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) faza e dytë përfshin procesin e shqyrtimit nga ana e Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike të dokumentacionit të dorëzuar nga sipërmarrësi turistik, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7;

c) faza e tretë përfshin verifikimin në terren, rast pas rasti, të të dhënave të vetëdeklarimit nga një grup pune ngritur me urdhër të ministrit, nëse komisioni i standardizimit e kërkon këtë proces.



Neni 5

Procesi i vetëdeklarimit për kategorizimin e strukturës akomoduese

1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

Formulari i vetëdeklarimit plotësohet në portalin elektronik të ministrisë përgjegjëse për turizmin, i aksesueshëm nëpërmjet portalit të shërbimeve shtetërore elektronike.

2. Sipërmarrësi turistik mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara, të cilat janë objekt i verifikimit, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6

Dokumentacioni i aplikimit për pajisjen me certifikatë kategorizimi

1. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti:

a) kërkesë për t'u pajisur me certifikatë kategorizimi sipas modelit, shtojca 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) formularin e vetëdeklarimit, sipas modelit, shtojca 3 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;

c) akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;

ç) vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

d) planimetrinë e strukturës akomoduese;

dh) vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

e) vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjieno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;

ë) foto të brendshme dhe të jashtme të objektit;

f) vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit / administratorit.

2. Dokumentacioni dhe/ose vërtetimet e kërkuara në pikën 1 të këtij neni, paraqiten në format origjinal ose kopje të noterizuara.

Neni 7

Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për kategorizimin e strukturave akomoduese

1. Komisioni i standardizimit, brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe raportit përmbledhës, rast pas rasti, të grupit të punës, shqyrtton dhe vlerëson dokumentet dhe të dhënat për përmbushjen e kriterëve të kërkuara për kategorizimin e strukturës akomoduese.

2. Komisioni i standardizimit, në rast të konstatimit të mangësive të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit, njofton brenda 10 ditëve nga data e aplikimit subjektin për plotësimin e dokumentacionit.

3. Sipërmarrësi turistik duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit për mangësitë e konstatuara.

4. Në rast se komisioni i standardizimit, gjatë shqyrtimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit shoqërues konstaton parregullsi apo lindin dyshime të arsyeshme për të dhënat e deklaruara, si dhe për përmbajtjen e dokumentacionit, i kërkon grupit të punës verifikimin në terren të të dhënave. Komisioni i standardizimit, nëpërmjet sekretarisë, njofton subjektin dhe grupin e verifikimit, si dhe koordinon vizitën në terren.

5. Grupi i punës, i ngritur me urdhër ministri, verifikon në terren parregullsitë e konstatuara nga komisioni i standardizimit dhe kriteret e detyrueshme për nivelin më të ulët të klasifikimit, të përcaktuara në VKM-në nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar.

6. Grupi i punës i paraqet Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike raportin përmbledhës të gjetjeve të konstatuara, brenda 5 ditëve nga dita e autorizimit të verifikimit.

7. Afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund të shtyhet, në mënyrë të arsyetuar, por jo më shumë se 60 ditë, duke i dërguar sipërmarrësit turistik një njoftim me shkrim, jo më vonë se përfundimi i afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

8. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, komisioni i standardizimit merr vendim



për lëshimin ose jo të certifikatës së kategorizimit të strukturës akomoduese dhe ia përcjell për miratim ministrit.

Neni 8

Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese

1. Certifikata e kategorizimit përmban:
 - a) emrin e subjektit dhe emrin tregtar;
 - b) NIPT-in;
 - c) emërtesën e strukturës akomoduese;
 - ç) adresën e strukturës akomoduese;
 - d) kategorinë;
 - dh) datën e lëshimit të certifikatës së kategorizimit;
 - e) nënshkrimin e ministrit.
2. Certifikata e kategorizimit, miratuar nga ministri, sipas formatit dhe modelit, shtojca 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, është tregues i llojit të strukturës akomoduese dhe afishohet në recepsionin apo zonën e pritjes së strukturës akomoduese.
3. Lloji i kategorisë së strukturës akomoduese vendoset në hyrjen kryesore (fasadën) e strukturës akomoduese, sipas certifikimit të kryer nga ministria përgjegjëse për turizmin.
4. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese regjistrohet, në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura

përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 9

Ndryshimi i dokumentit të kategorizimit

1. Sipërmarrësi turistik, që pajiset me certifikatën e kategorizimit, në rast se kryen ndërhyrje apo ndryshime në objekt, ka detyrimin të njoftojë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
2. Në rast se Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike çmon të arsyeshme se ndryshimet e njoftuara nga sipërmarrësi turistik mund të ndikojnë në kategorizimin e strukturës akomoduese, ministria mund të nisë procedurën e rishqyrtimit të statusit të kategorizimit.

Neni 10

Verifikimi

1. Inspektorati përgjegjës për turizmin ka përgjegjësi të verifikojë çdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtari si strukturë akomoduese, nëse është apo jo i pajisur me certifikatë kategorizimi.
2. Inspektorati përgjegjës për turizmin, në rast të konstatimit të ushtrimit të veprimtarisë si strukturë akomoduese, në mungesë të certifikatës së kategorizimit njofton ministrinë përgjegjëse për turizmin për të marrë masa sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.



SHTOJCA NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

CERTIFIKATË KATEGORIZIMI STRUKTURË AKOMODUESE

Kjo certifikatë i lëshohet

[Emri subjektit]
[Emri tregtar]

NIPT _____

[Emërtesa e strukturës akomoduese]

Adresa: [Adresa e strukturës akomoduese]

për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese

Kategoria:[Kategoria e strukturës akomoduese]

Lëshuar më _____._____._____
Nr. Regj._____/2019

MINISTRI



SHTOJCA NR. 2

KËRKESË

Lënda: Kërkesë për t'u pajisur me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese

Aplikim për:

- ☐ Bujtinë ☐ Fjetinë ☐ Kamping ☐ Hotel ☐ Motel
☐ Resort ☐ Qendër Kurative ☐ Fjetje dhe mëngjes (B&B).

Emri i subjektit aplikues: _____

NIPT: _____

Adresa e subjektit: _____

Personi që përfaqëson subjektin: _____

Nr. tel.: _____ *Email:* _____

Përmbledhje ekzekutive e subjektit aplikuesit

(Përshkrim të veprimtarisë të cilën subjekti ushtron, eksperiencën konkrete sipas periudhave etj.)

Dokumentacioni shoqërues i aplikimit

(Listë e dokumenteve shoqërues të aplikimit)

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- 6.
- 7.
- 8.
- 9.
- 10.

.....

SUBJEKTI APLIKUES/PERSONI I AUTORIZUAR

(Emër, mbiemër, firma, vula)



SHTOJCA NR. 3

Formular vetëdeklarimi për aplikim për kategorizimin e strukturave akomoduese

Kategoria për të cilën aplikon:

- | | | |
|--|---------------------------------|---|
| ☐ Bujtinë | ☐ Hotel | ☐ Qendër kurative |
| ☐ Fjetinë (hostel); | ☐ Motel | ☐ Fjetje dhe mëngjes (B&B) |
| ☐ Kamping | ☐ Resort | |

Detajet e aktivitetit	NIPT		
	Emri i subjektit		
	Emri tregtar		
	Përfaqësuesi ligjor F ☐ M ☐		
	Forma e pronësisë		
	Vlera e investimit		
	Viti i operimit		
	Aktiviteti ushtrohet		☐ Gjithë vitin ☐ Sezonal
	Adresa e plotë e aktivitetit (prefektura, bashkia, qyteti/fshati, lagjja, rruga, nr.)		
	Vendndodhja gjeografike (GIS)		
Kapaciteti i strukturës	Kapaciteti akomodues në dhoma		
	Kapaciteti akomodues në shtretër		
	Kapaciteti në bar-kafe, vende ulje (persona)		
	Kapaciteti në restorante, vende ulje (persona)		
	Nr. i sallave për konferenca		
	Kapaciteti për sallë		
Mjete kontakti	Email		
	Telefon fiks		
	Mobile		
	Website		
Kategoritë e punësimit	Punonjës me kohë të plotë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kohë të pjesshme	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kontratë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	



	Të vetëpunësuar	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
Kualifikimi i punonjësve	Me arsim të lartë		
	Me arsim të mesëm të përgjithshëm		
	Me arsim të mesëm profesional		
	Me certifikata/diploma ndërkombëtare		
	Me certifikatë kualifikimi etj.		
Informacione të tjera	Numri i kateve të strukturës akomoduese		
	Ashensor		
	Dhoma pa tualet personal		
	Tualete të përbashkëta		
	Vende parkimi		
	Pishinë		☐ e jashtme
			☐ e brendshme
	Mjedise të tjera argëtuese e sportive		
	Ofrim i vakteve të tjera		
	Ofrim i akomodimit për një kohë të shkurtër (më pak se një natë fjetjeje)		
	Pronari i strukturës fle në të njëjtën strukturë		
	Struktura është në funksion të veprimtarisë “agroturizëm”	☐ Po	☐ Jo

Unë, i nënshkruari _____, deklaroj se jam njohur me urdhrin e ministrit nr. _____, datë _____2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e kategorizimit të strukturave akomoduese” dhe plotësoj të gjitha kriteret e parashikuara në shtojcën 4, për kategorinë e strukturës akomoduese për të cilën kam aplikuar.

Mbaj përgjegjësi të plotë për të dhënat e deklaruara më sipër.



SHTOJCA 4/a

Kriteret e detyrueshme – Bujtina

Fushat	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi bujtinën		
Ndërtesa	1	Bujtina është një godinë që ka kryesisht stil tradicional rajonal, të integruara në mjedisin rrethues - përputhen me traditën dhe arkitekturën lokale të vendit.
	2	Dekore sipas stilit lokal (dekorimet janë në stilin tradicional, tipik të rajonit/vendit. Kur dekorimet janë funksionale, ato nuk duhet të paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë.
	3	Sendet personale të pronarëve të shtëpisë pritëse nuk duhet të jenë në ambientet që shfrytëzohen nga klientët.
Mirëmbajtja, pastërtia dhe siguria	4	Gjendja e ndërtesës të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe e mirëmbajtur. Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuar.
	5	Dhomat, ambientet e përbashkëta, korridoret dhe vendet ku kalohet, të mbajtura pastër në çdo kohë.
	6	Të gjitha tualetet dhe dhomat e dusheve pastrohen çdo ditë kontrollohen për të siguruar standardet e përshtatshme të pastërtisë (1).
	7	Gjendje e mirë dhe ndriçim i përshtatshëm i fasadave dhe i ambienteve të mbikëqyrura prej bujtinës.
	8	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet jo më pak se 12 orë në ditë.
	9	Të gjitha pajisjet elektrike ose të gazit duhet të mirëmbahen, të jenë në vend të sigurt dhe në gjendje të mirë pune.
II. Ambienti i përbashkët/për publikun		
Zona e mirëseardhjes	10	Të disponojë një zonë mirëseardhjeje.
	11	Pritësi në zonën e mirëseardhjes të jetë i aftë për të komunikuar në anglisht.
	12	Bujtina ofron shërbim <i>check-in</i> nga ora 07:00–19:00.
	13	Person përgjegjës i arritshëm në telefon, në intervalin kohor 19:00–07:00 (në rastet kur pronari nuk jeton në të njëjtën bujtinë).
	14	Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit.
	15	Informacion për zonën, aktivitetet që kryen, kulturën, traditat ose atraksione të tjera objekte për të vizituar (p.sh., si: muzetë, kështjella, evente, parqe natyrore, aktivitete miqësore) (2).
	16	Klientët informohen saktë në formë elektronike ose me materiale të printuara për shërbimet që ofrohen.
	17	Regjistrimi i klientëve të bujtinës në një regjister të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
	18	Pronari ose personeli duhet të jenë në krye të detyrës gjatë mbërritjes dhe nisjes së klientëve, si dhe gjatë kohës së vaktit (mëngjes, drekë/darkë).
	19	Klienti njoftohet në kohë për çdo situatë që mund të ndikojë negativisht në qëndrimin e tij në bujtinë.
	20	Aksesi në dhomë sigurohet gjatë gjithë qëndrimit të klientit në bujtinë.
	21	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve.
	22	Një tharëse flokësh të jetë në dispozicion të klientëve.
	23	Kuti e ndihmës së shpejtë e pajisur siç duhet.
	24	Sistem për thirrjen e urgjencës mjekësore.
Korridoret, shkallët, kalimet dhe hapësirat e përbashkëta	25	Shenja treguese të vendosura qartë për daljet e emergjencës, dhomat, ashensorët (nëse ka), receptionin dhe ambiente të tjera.
	26	Sistem efektiv i ventilimit: natyral ose mekanik.
	27	Duhet të ketë një dhomë ndenjeje dhe zonë ngrënieje.
	28	Në rastin kur në dhomat e gjumit nuk ka televizorë, duhet të ketë një të tillë në një dhomë/sallë ndenjeje që ka mobilie të rehatshme.
	29	Korridoret dhe shkallët të lira nga çdo pengesë.
	30	Niveli i ndriçimit në të gjitha hapësirat publike duhet të jetë i përshtatshëm për siguri dhe



		rehati. Shkallët dhe sheshpushimet duhet, gjithashtu, të kenë dritë të mjaftueshme gjatë natës.
III. Dhomat e gjumit për klientët		
Të përgjithshme	31	Secila dhomë të ketë hyrje të veçantë dhe të pavarur (3) dhe të tregohet me numra ose shenja të tjera.
	32	Nuk lejohen shtretër të mbivendosur (tip marinari) dhe shtretër portativë (4).
	33	Numri maksimal i: - shtretërve shtesë: 2; - personave në dhomë: 4.
*Standardi i hapësirës së dhomës	34	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 9 m ² dhe ka hapësirë për të siguruar lëvizjen e lehtë nëpër dhomë.
	35	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë), kur kemi akomodim me vetëshërbim (5) është 8 m ² .
	36	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 13 m ² .
	37	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë), kur kemi akomodim me vetëshërbim (6) është 12 m ² .
	38	Sipërfaqe dhome shtesë prej 3 m ² për çdo person tjetër të shtuar.
*Kriteret dhe sipërfaqet nuk janë të vlefshme për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si monument kulture.		
Shtrati (Përmasat dhe cilësia)	39	Përmasa minimale e shtratit tek: 80 cm x 190 cm; Përmasa minimale e shtratit dopio: 140 cm x 190 cm.
	40	Shtrojat: 2 çarçafë, këllëf jastëku, batanije dhe mbulesë.
	41	Jastëk shtesë për çdo person sipas kërkesës.
	42	Batanije shtesë për çdo person sipas kërkesës.
	43	Shtrojat ndërrohen të paktën një herë në javë ose sipas kërkesës së klientit dhe për çdo klient të ri.
	44	Të gjithë dyshekët duhet të jetë të rehatshëm, të pastër, pa njolla apo erë, në gjendje të mirë.
	45	Të gjithë shtretërit duhet të rregullohen çdo ditë.
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	46	Dritare/balkon që lejon hyrjen e dritës natyrale dhe ajrosjen në dhomë.
	47	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokoi dritën natyrale/dritat e jashtme.
	48	Një karrige ose kolltuk.
	49	Së paku një komodinë për çdo dy persona ose dy komodina për çdo 3 persona.
	50	Një kosh mbeturinash.
	51	Një pasqyrë vertikale për veshje.
	52	Dollap rrobash me 5 varëse rrobash për person.
	53	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv.
	54	Dritë leximi individuale.
Shërbime shtesë në dhomë	55	Të paktën një dritë të kontrolluar që nga dera.
	56	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurt të gjitha pajisjeve elektrike individuale dhe atyre që ofrohen nga bujtina.
	57	Të sigurojë minimalisht thirrjet telefonike brenda vendit.
	58	Të sigurojë shërbimet e mirëmbajtjes.
	59	Të disponojë një udhëzues për ndihmën në raste të emergjencës.
	60	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhome.
Struktura dhe pajisjet sanitare	61	Një gotë uji për çdo person.
	62	Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet pronari/personeli në rast emergjence gjatë 24-orëve.
	63	Një tualet në kat dhe së paku një për çdo 6 persona (7).
	64	Ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	65	Letër higjienike.
	66	Lavaman.
	67	Sapun të pakeluar ose sapun të lëngshëm.
	68	Kosh për mbetjet higjienike.
	69	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda.
IV. Tualeti, dushet dhe pajisjet sanitare		



	70	Të gjitha tualetet duhet të jenë të ndriçuar mirë dhe temperatura e ambientit të jetë e përshtatshme.
	71	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit/vaskës e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji).
	72	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike etj.) deri në lartësinë 1,20 m.
	73	Dy peshqirë për person (fytyrë dhe trupi) dhe varëset përkatëse.
	74	Marrja e masave kundër rrëshqitjes në ambientet sanitare.
	75	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë.
	76	Çdo zonë sanitare të ketë një sistem të efektshëm të ventilimit natyral ose mekanik.
	77	Një varëse rrobash për dushet e përbashkëta.
	78	Priza elektrike për përdorim të sigurt të të gjitha pajisjeve elektrike.
Lavamani në dhomë	Kur një lavaman është i vendosur në dhomën e gjumit duhet të ketë:	
	79	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë;
	80	Një mbajtëse peshqiri (8);
	81	Një peshqir duarsh ose pajisje për tharjen e duarve;
	82	Sapun të paketuar ose sapun të lëngshëm në dhomë.
V. Zona e ngrënies		
Shërbimi mëngjesit	83	Dhomë/mjedis për ngrënien e mëngjesit me kushte të përshtatshme për akomodimin e një kapaciteti maksimal klientësh.
	84	Të ofrohet mëngjes i mjaftueshëm (9) dhe i shërbyer sipas standardeve.
	85	Aksesorët për ngrënie të përshtatshëm dhe të mjaftueshme për t'i shërbyer një kapaciteti maksimal klientësh, të ulur në dhomën/mjedisin e ngrënies së mëngjesit. (10).
	86	Aksesorët për ngrënie janë të padëmtuar dhe u përmbahen kushteve optimale higjienike.
	87	Një kuzhinë ose ambient, për përgatitjen e ushqimit të mëngjesit.
	88	Hapësirë/mjedis të pastër, të rregullt dhe të përshtatshëm për magazinim.
Dreka/darka (nëse ofrohet)	89	Ushqimi që shërbehet përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet, si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore e shtazore (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse) (11).
	90	Ofrim i ushqimit vegjetarian sipas kërkesës.
VI. Kuzhina (në rastet e akomodimit me vetëshërbim) (12)		
Pajisjet e kuzhinës	91	Frigorifer
	92	Lavapjatë me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	93	Një furrë dhe sobë me të paktën 2 plitka
	94	Një aspirator
	95	Servis gatimi dhe ngrënie (13) për të paktën 6 persona
	96	Mjete për të siguruar higjienën
	97	Të paktën dy peshqirë kuzhine
	98	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
VII. Menaxhimi dhe stafi		
	99	Bujtina duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një personi, të aftë për ta drejtuar atë sipas standardeve të vendosura në këtë rregullore.
	100	Stafi duhet të jetë i veshur në mënyrën e duhur, pastër dhe të jenë të kujdesshëm në çdo kohë.

(1) Tualetet dhe dhomat e dushave janë të pastra dhe me aromë të freskët.

(2) Ky informacion mund të jepet në formën e broshurave, revistave ose nëpërmjet komunikimit verbal.

(3) Dhomat që kanë komunikim me njëra-tjetrën do të quhen si një dhomë e vetme.

(4) Ky kriter nuk është i vlefshëm për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si monument kulture.

(5) Një akomodim vetëshërbimi mund të përkufizohet si një shtëpi pushimi ose vilë e pastër, e rehatshme, e mobiluar dhe e pajisur me mjetet për të përgatitur dhe për të gatuar vetë ushqimin.

(6) E vlefshme kjo sipërfaqe minimale e zonës së kuzhinës edhe për zonën e kuzhinës që përdoret nga persona të dhomave të ndryshme.

(7) Në rastet kur dushi/vaska dhe WC-ja janë në ambiente të ndara, vlen po i njëjti rregull.

(8) Një radiator nuk është i pranueshëm, por një unazë për mbajtjen e peshqirit ose një raft afër radiatorit është i përshtatshëm.

(9) Mëngjes i mjaftueshëm ofron të paktën një pije të ngrohtë (kafe ose çaj), një lloj buke, drithëra, gjalpë, reçel/mjaltë/lloj tjetër kremrash të ëmbël, vezë, qumësht.

(10) Gota, pjata, filxhanë, peceta, servis i ngrënies.

(11) Preferohet që për vaktin e drekës apo të darkës të ofrohen ushqime tradicionale të zonës

(12) Në këtë rast, nuk aplikohen kriteret për shërbimin e mëngjesit, drekës dhe darkës.

(13) Të tilla, si: tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngrënie, filxhanë, gota etj.



SHTOJCA 4/b

Kriteret e detyrueshme - Fjetinë (hostel)

Fushat	Nr.	Kriteret
I. Të përgjithshme		
Ndërtesa dhe gjendja e përgjithshme	1	Struktura akomoduese duhet të jetë një godinë e veçantë. Godina të ketë një konstruksion të qëndrueshëm, të sigurt dhe të jetë e mirëmbajtur tërësisht.
	2	Të jetë e përshtatshme për aktivitetin që zhvillohet dhe e pajisur për qëllime të ofrimit të shërbimeve të fjetinës.
	3	Struktura akomoduese duhet të përdoret për akomodim të klientëve që paraqiten me ose pa rezervim, duke i siguruar atyre shërbim në orare të arsyeshme.
	4	Ndriçim i mjaftueshëm jashtë dhe brenda godinës, për të siguruar një funksionim normal të aktiviteteve, si p.sh., lexim, ngrënie etj.
	5	Sistem ngrohje/ftohje që siguron një temperaturë të rehatshme në të gjitha ambientet e brendshme, si dhe ventilim natyral ose mekanik.
Mirëmbajtja, pastërtia dhe Siguria	6	Të gjitha ambientet pastrohen dhe kontrollohen 3 herë në javë, për të siguruar një standard të lartë pastërtie.
	7	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet 8 orë në ditë.
	8	Hyrje e kontrolluar në portën kryesore për të mundësuar sigurinë e klientëve dhe të sendeve të tyre.
	9	Ambient për magazinimin e materialeve dhe të pajisjeve për përdorim të brendshëm, si p.sh., materiale pastrimi, çarçafë dhe jorganë shtesë etj.
II. Ambienti i përbashkët/për publikun		
Zona e pritjes	10	Zona e pritjes e pajisur me tryezë ose banak për t'u shërbyer klientëve.
	11	Regjistrimi i klientëve të fjetinës në një regjistër të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
	12	Kënd për paraqitjen e materialeve informative të përditësuara, si dhe oferta për aktivitete të ndryshme të organizuara.
	13	Person përgjegjës i aftë të komunikojë anglisht dhe të asistojë nevojat e klientëve.
	14	Person përgjegjës për të shërbyer të paktën 12 orë në ditë
	15	Procedura të qarta dhe lehta të mënyrës së pagesës. Rezervimet duhet të jenë në dispozicion përmes formave të ndryshme (telefon, email, prenotim direkt, online etj.).
	16	Afishim i informacionit për rregullat, oraret dhe shërbimet e funksionimit të fjetinës.
	17	Sistem i sigurt për depozitat e sendeve personale.
	18	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve.
	19	Kutia e ndihmës së shpejtë në recepsion.
	20	Telefon publik në zonën e pritjes dhe afishim i numrave të emergjencës. Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet personeli në raste emergjence gjatë 24 orëve.
	21	Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit.
Dhoma e përbashkët	22	Zona e pritjes duhet të jetë e ndarë nga zona e kuzhinës/e ngrënies.
	23	Struktura duhet të ketë të paktën një dhomë të përbashkët.
	24	Dhoma e përbashkët duhet të përmbajë mobilie dhe pajisje funksionale.
III. Dhomat e gjumit për klientët		
Të përgjithshme	25	Numri maksimal i personave në dhomë: 12.
	26	Të gjitha dhomat kanë hyrje të veçantë dhe të pavarur (1).
	27	Dhomat të kenë numër ose emër, të vendosur në mënyrë të qartë.
	28	Fjetoret duhet të ndahen sipas gjinive. Nëse nuk është e mundur, klientët duhet të informohen në kohën e rezervimit.
	29	Nuk lejohet akomodimi i të miturve të pashoqëruar në fjetoret me gjini të përziera. Në fjetore duhet të afishohet qartë ky shënim.
	30	Hapësirë e mjaftueshme në dhomë për të lëvizur lirshëm. Dhoma duhet të jetë në madhësinë e duhur dhe të mobiluara për të siguruar nivele normale përdorimi.
Standardi i hapësirës së dhomës	31	Nëse shtretërit përbëhen vetëm nga një njësi (tek), hapësira organizohet duke ruajtur raportin 50% sipërfaqe e lirë.
	32	Nëse shtretërit përbëhen vetëm nga dy njësi (marinar) ose përzierje e të dyja llojeve, hapësira



		organizohet duke ruajtur raportin 60% sipërfaqe e lirë.
	33	Sipërfaqja minimale e dhomës për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet) 5 m ² .
	34	Sipërfaqja minimale e dhomës për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet) 7 m ² .
	35	Sipërfaqe dhome shtesë e nevojitur për çdo person tjetër të shtuar me shtrat tek/marinar 3 m ² /2 m ² .
Shtrati (përmasat dhe cilësia)	36	Përmasa minimale e shtratit tek: 80 cm x 190 cm.
	37	Përmasa minimale e shtratit dopio: 140 cm x 190 cm.
	38	Shtrojat: 2 çarçafë pambuku të pastër njëngjyrësh, mbulesë/jorgan, këllëf jastëku.
	39	Një jastëk për person.
	40	Jastëk/batani shtesë për çdo person sipas kërkesës.
	41	Të gjitha shtrojat duhet të jenë të pastra dhe në sasi të mjaftueshme, në bazë të sezonit dhe nevojave të klientit.
	42	Shtrojat ndërrohen për çdo klient të ri dhe të paktën një herë në javë ose sipas kërkesës së klientit (me ose pa pagesë).
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	43	Dritare/ballkon për ndriçim natyral, si dhe ventilim natyral ose mekanik.
	44	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokoi dritën natyrale/dritat e jashtme.
	45	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurt të të gjitha pajisjeve elektrike individuale.
	46	Kosh mbeturinash.
	47	Mundësi për akses individual në dhomë (çelës, kartë etj.).
IV. Tualeti, dushet, dhe pajisjet sanitare		
Të përgjithshme	48	Një banjë në kat dhe së paku një për çdo 6 persona.
	49	Në rastet kur dushi dhe WC-ja janë në ambiente të ndara, duhet të ketë një WC-ja dhe dush për çdo 8 persona ose nga një në çdo kat.
	50	Në rastet kur dushi dhe WC-ja janë në ambiente të ndara, duhet të ketë lavaman në secilën prej tyre.
	51	Duhet të ketë privatësi mes gjinive në dushe dhe tualete.
	52	Ambientet e dusheve dhe të dhomave të zhveshjes duhet të kenë ndarëse ose dritare opake për të siguruar privatësi.
	53	Të gjitha pajisjet sanitare duhet të jenë funksionale dhe të mirëmbajtura.
	54	Ujë i rrjedhshëm i ftohtë dhe i ngrohtë.
Pajisjet sanitare	55	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe muret me material izolues, që pastrohet dhe mirëmbahet lehtë.
	56	Ambientet sanitare duhet të jenë të pajisura si më poshtë: pasqyrë, varëse peshqiri dhe rrobash, kapak WC-je, mbajtëse sapuni dhe sapun të pakeluar ose të lëngshëm, letër higjienike në mbajtësen përkatëse, kosh për mbetjet higjienike.
	57	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda.
	58	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji).
V. Zona e ngrënies		
Shërbimi i mëngjesit, dreka/darka (nëse ofrohet)	59	Përmasat e zonës së ngrënies, si dhe serviset e ngrënies (pjata, gota, lugë, pirunë etj.) të jenë në proporcion me kapacitetin e fjetinës.
	60	Tryezat dhe karriget duhet të jenë në numër të mjaftueshëm dhe të vendosura në mënyrë të përshtatshme për të mundësuar kalim pa pengesa të stafit.
	61	Serviset e ngrënies (pjatat, gotat, mbulesat etj.) duhet të jenë në gjendje të mirë.
	62	Shërbimi nuk duhet të kalojë përmes zonave të përbashkëta që përdoren si zonë pritjeje ose korridore kryesore.
	63	Ushqimi mund të jetë i kufizuar në zgjedhje, por duhet të jetë i një cilësie të mirë, që u përmbahet standardeve të përcaktuara nga legjislacioni (2).
	64	Duhet të ketë personel të mjaftueshëm në dispozicion për të shërbyer.
	65	Nëse kërkohet në kohën e rezervimit, duhet të ketë të paktën një opsion për ofrimin e një ushqimi vegetarian.
VI. Kuzhina me vetëshërbim (nëse ofrohet)		
Pajisjet e kuzhinës	66	Mjedis përgatitjeje dhe gatimi për klientët, për të mbajtur, për të ruajtur, për të përgatitur dhe për të konsumuar ushqime të ngrohta dhe të ftohta, i cili përmbush kriteret e higjienës.
	67	Të ketë përmasa të përshtatshme në proporcion me kapacitetin e fjetinës dhe pajisjet e saj të jenë në gjendje funksionale.
	68	Frigorifer ose njësi ftohëse.



	69	Tavolinë ose njësi për përgatitjen e ushqimit me sipërfaqe të padëmtuar dhe që pastrohet lehtësisht.
	70	Pajisje gatimi.
	71	Lavaman me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë.
	72	Kosh plehrash me kapak në vendndodhje të përshtatshme. Nuk lejohet të mbahen plehrat në kuzhinë dhe duhet të hiqen rregullisht.
	73	Pjata, gota, pirunë, lugë, thika në sasi të mjaftueshme që të mbulojnë nevojat e klientëve që akomodohen.
	74	Kuzhina duhet të jetë e vendosur pranë ose lehtësisht e aksesueshme nga zona e ngrënies.
VII. Shërbime shtesë		
	75	Ambient i përshtatshëm për larjen dhe tharjen e rrobave, si dhe mjaftueshëm, makina larëse për të mbuluar nevojat e klientëve.
	76	Veprimtari argëtuese (3)
VIII. Menaxhimi dhe stafi		
	77	Fjetina duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një personi, të aftë për ta drejtuar atë sipas standardeve të vendosura në këtë rregullore
	78	Stafi duhet të jetë i veshur në mënyrën e duhur, pastër dhe kujdesshëm në çdo kohë

(1) Dhomat që kanë komunikim me njëra-tjetrën do të quhen si një dhomë e vetme.

(2) Menuja duhet të përmbajë të paktën 6 nga lista e mëposhtme, lloje pijesh të ngrohta dhe të ftohta, një lloj buke, një lloj ëmbëlsire, një lloj drithi, reçel/marmelatë/mjaltë, gjalpë, vezë, djathë, kos, sallam, fruta e të tjera.

(3) Tavolinë bilardoje, makinë lojërash, akses në internet, pingpong, bibliotekë, dhomë lojërash, internet kafe etj.

SHTOJCA 4/c

Kriteret e detyrueshme – Kamping

Fusha	Nr.	Kriteret
I. Të përgjithshme		
Kapaciteti	1	Të paktën 10 parcela, ku “parcela” nënkupton vend qëndrimi të përkohshëm të karavanëve/tendave (tenda, vend për kamperin).
	2	Të paktën 70% e hapësirës duhet të jetë për parkimin e përkohshëm të <i>camper/caravan</i> , shtëpive të lëvizshme, tendave ose pajisjeve të tjera të marra me qira nga klientët.
	3	30% e hapësirës duhet të jenë njësi të ndërtuara ose pajisje të palëvizshme kampingu për shërbimet e tjera ndaj klientit (receptsi/ambientet sanitare/restorant etj.).
Hyrje-dalja	4	Rrethim natyror ose artificial i vendosur rreth kampit.
	5	Hyrje-dalje e përshtatshme dhe e ndriçuar për automjetet në kamp.
	6	Hyrja kryesore dhe i gjithë kampingu i pajisur me sinjalistikë rrugore për kufizim shpejtësie të lëvizjes së automjeteve në brendësi të kampikut (përfshirë police të shtrirë) dhe sinjalistikë për godinat e shërbimeve të ofruara.
Lidhjet dhe lëvizshmëria	7	Ndalim qarkullimi me automjete në brendësi të kampikut në orët e natës.
	8	Lidhje me rrugët publike.
	9	Rruga kryesore e brendshme me material të fortë (beton, pllaka guri, asfalt, zhavorr etj.).
Hedhja e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme	10	Shtigjet komunikuese me gjerësi të mjaftueshme (jo më pak se 1 m) dhe lehtësisht të përshkueshme.
	11	Të gjitha rrugët dhe shtigjet të jenë të ndriçuara dhe të mirëmbajtura.
	12	Mbajtja e mbeturinave në kontenitorë të mbyllur: largim i mbeturinave rregullisht.
Mirëmbajtja	13	Pajisja e të gjithë hapësirës së kampikut me kosha plehrash.
	14	Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve, mobileve dhe objekteve që ofrohen nga kampingu, në gjendje funksionale pune.
	15	Kampingu duhet të dezinfektohet të paktën një herë në vit.
II. Receptsi dhe shërbimi i pritjes		
Receptsi	16	Kampingu përmban një ambient për pritjen (receptsi), përcjelljen e klientëve dhe kontrollin e personave që vizitojnë kampin, i cili ndodhet pranë hyrjes, i dallueshëm për klientët, i pajisur me një banak/një tavolinë e karrike.
	17	Regjistrimi i klientëve të kampikut në një regjister të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e



		pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
	18	Recepsioni mbahet pastër në çdo kohë.
	19	Recepsioni është i pajisur me ngrohje, përveç kampeve që operojnë në verë.
	20	Recepsion i hapur të paktën 8 orë, me orar të afishuar në ambientet e recepsionit.
	21	Shërbimi i sigurisë përgjatë natës.
	22	Numër telefoni i afishuar për personin përgjegjës, i cili është i arritshëm në telefon 24 orë për pushuesit e kampingut.
	23	Recepsionisti ka njohuri bazë në të paktën një gjuhë të huaj.
	24	Sistem i sigurt për materialet me vlerë në zonën e pritjes.
	25	Kuti e ndihmës së shpejtë e pajisur siç duhet.
	26	Shërbim telefoni publik në ambientin e pritjes dhe afishim i numrave të emergjencës.
	27	Shërbim interneti (Wi-Fi).
	28	Informacione dhe fletëpalosje për zonën.
	29	Për një akses të drejtpërdrejtë, në një vend të dukshëm në ambientin e pritjes, janë të afishuara rregullat e njësisë, të shtypura në gjuhën shqipe dhe angleze.
	30	Afishim i planimetrisë së kampingut, ku reflektohet ndarja e parcelave të kampingut dhe i strukturave të shërbimeve.
	31	Çmimet e të gjitha shërbimeve dhe të dhënies me qira të pajisjeve, janë të afishuara në vendin më të dukshëm, në ambientin e pritjes (recepsion).
	32	Të paktën 2 vende parkimi në afërsi të recepsionit
III. Njësitë bazë të akomodimit		
Parcelat	33	Zona për vendosjen e mjeteve të lëvizshme të ndara zonat për tenda dhe zonat për karavan dhe kamper.
	34	Hapësira për kampingun e sistemuar (pastruar nga bimët, gurët etj.)
	35	Kampingu i ndan parcelat sipas përmasave të njësisë së akomodimit duke respektuar të paktën 5 metra hapësirë të lirë në të gjitha anët e tendës/kamperit dhe karavanës.
	36	80% e parcelave duhet të ketë mundësi për furnizim me energji elektrike.
	37	Nëse kampingu ofron edhe akomodim në shtëpi druri apo struktura të tjera të palëvizshme, këto të fundit nuk mund të jenë më shumë se 20% e sipërfaqes totale të kampingut dhe duhet të respektojnë kushtet e parashikuara për shtëpitë e drurit/vilat në aneksin mbi resortet.
IV. Nyjat sanitare		
Të përgjithshme	38	Në kampingjet që kanë mbi 50 njësi, nyjat sanitare (WC dhe dushe) duhet të jenë të vendosura në dy hapësira të ndryshme, të shpërndara për të mundësuar aksesin e lehtë nga të gjithë pushuesit e kampingut.
	39	Për çdo 30 parcela, kampingu ka të paktën:
		- 3 WC për burra dhe 3 për gra;
		- 2 dushe për burra dhe 3 për gra;
		- 4 lavamanë me pasqyrë.
	40	Për çdo 10 parcela shtesë, ka të paktën 1 tualet, dush dhe lavaman shtesë.
	41	Ambientet sanitare duhet të kenë një largësi minimale prej 10 m nga parcelat, por gjithsesi në një largësi të përshtatshme dhe lehtësisht të arritshme nga të gjithë.
	42	Dyer jotransparente deri në lartësinë 2 m, të pajisura me sistem për mbylljen e derës.
	43	Prizë energjie elektrike në afërsi të lavamanëve.
Ambienti i dushit	44	Furnizimi me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë.
	45	Kontenitor mbeturinash.
	46	Hapësira e dushit/kabina/ndarja e dushit nuk duhet të jetë më e vogël se 100 x 160 cm.
Higjiena dhe kushtet e përgjithshme	47	Mbajtëse peshqiri.
	48	Mbajtëse rrobash.
	49	Dysheme, tavane dhe mure të pastra.
	50	Dyshemeja dhe muret e nyjave sanitare është e shtruar me material jo të rrëshqitshëm dhe izolues nga uji, që pastrohet lehtësisht.
	51	Pajisjet sanitare të pastruara dhe dezinfektuara.
	52	Instalime funksionale (elektrike, hidraulike etj.).
	53	Të kenë ndriçim të përshtatshëm.
	54	Ventilim natyral ose mekanik.
	55	Sistem ngrohje, përveç aktiviteteve që operojnë vetëm në verë.



Tualetet kimike (nëse ka)	56	Tualetet kimike lejohen vetëm nëse sigurohet shërbimi për pastrimin dhe për mirëmbajtjen e tyre.
	57	Në kabinë vendoset tabelë me emërtimin: “Kabinë kimike”, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.
	58	Rubinet me ujë të ftohtë me tub fleksibël për pastrim.
	59	Lavaman me ujë të rrjedhshëm.
	60	Ndriçim i përshtatshëm.
	61	Ventilim natyral ose mekanik.
V. Ambienti për larjen e enëve dhe veshjeve personale		
Ambienti për larjen e enëve	62	Dy lavapjata inoksi për çdo 50 vende kampimi.
	63	Në ambientin për larjen e enëve vendoset tabelë me emërtimin: “Ambient për larjen e enëve”, në gjuhën shqipe dhe angleze.
	64	Zonë e mbuluar për larjen e enëve.
	65	Deri në 50% të lavapjatarave mund të zëvendësohen me makinë larëse në raportin 1 makinë larëse zëvendëson 3 lavapjata.
Ambienti për lavanderinë e veshjeve personale	66	Dy vaska për larjen e veshjeve ose një vaskë e pajisur me dy rubineta, me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë për 50 parcela.
	67	Në ambientin për larjen e veshjeve vendoset tabelë me emërtimin: “Ambient për larjen e veshjeve”, në gjuhën shqipe dhe angleze.
	68	Zonë e mbuluar për larjen e veshjeve.
	69	Deri në 50% të vaskave të larjes mund të zëvendësohen me makinë larëse, në raportin 1 makinë larëse zëvendëson 3 vaska larëse.
VI. Elemente të tjera		
Shërbime	70	Mjedise ose struktura për ofrimin e ushqimit dhe pajisjeve bazë të nevojshme për kamping, nëse këto nuk mund të blihen në një dyqan/restorant tjetër, jo më larg se një km nga kampingu.
Aktivitete sportive rekreative	71	Kampingjet, me kapacitet deri në 50 njësi, duhet të ofrojnë të paktën një nga aktivitetet e listuara më poshtë.
		Kampingjet, me kapacitet mbi 50 deri në 100 njësi, duhet të ofrojnë të paktën dy nga aktivitetet e listuara më poshtë.
		Kampingjet, me kapacitet mbi 100 njësi, duhet të ofrojnë të paktën tri nga aktivitetet e listuara më poshtë.

SHTOJCA 4/d

Kriteret minimale - Hotel

Fusha	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi hotelin		
Ndërtesa	1	Ambientet përfshijnë një ose më shumë ndërtesa që ndodhen në të njëjtën shesh/vend (i cili përmban edhe ndërtesën kryesore të hotelit) dhe që janë fizikisht të lidhura me shtigje të ndriçuara dhe ndajnë hyrje dhe dalje të përbashkëta.
	2	Në rastin e hotelit të përbërë nga disa ndërtesa, këto ndërtesa duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe fizikisht të lidhura me ndërtesën kryesore me shtigje të ndriçuara mirë. Këto ndërtesa përfshijnë dhomat e klientëve me tualete private, ambiente magazinimi, shkallë dhe korridore që përmbushin kriteret e parashikuara më poshtë.
	3	Hoteli i përbërë nga disa ndërtesa operon nën mbikëqyrjen e rregullt dhe mirëmbajtjen e menaxhimit dhe stafit të ndërtesës kryesore të hotelit.
Pastërtia/Higjiena	4	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore në të gjitha kategoritë - kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese (dyshemetë, muret, tavanet, mobilet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera).
Mirëmbajtja	5	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune.
Përshtypja e përgjithshme	6	Përshtypja e përgjithshme është e mjaftueshme për kërkesa të thjeshta [1].
	7	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe i udhëzimeve në rast zjarri.
	8	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
	9	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për strukturat akomoduese (VKM nr. 699, datë 22.10.2004, “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”).



II. Recepsioni dhe shërbimet		
Recepsioni	10	Hapësirë vizualisht e ndarë/tavolinë e dedikuar për shërbimet e recepsionit.
	11	Shërbimi i pritjes (recepsionit) dhe person në dispozicion për <i>check-in</i> , sipas një marrëveshjeje.
	12	Protokoll i brendshëm i hotelit lidhur me detyrat e stafit sipas profileve të tyre.
	13	Regjistrim i klientëve të hotelit [2].
	14	Vendosja e numrave të shërbimeve mjekësore dhe të urgjencës.
	15	Kutia e ndihmës së shpejtë në recepsion.
	16	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit, në përputhje me ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”.
	17	Kasafortë qendrore në recepsion/facilitete të ruajtjes së sendeve me vlerë.
	18	Shërbim i ruajtjes së bagazheve.
	19	Tualetet të përbashkëta në recepsion [3].
Të ndryshme	20	Material informues për rajonin, të vendosura në ambientet e përbashkëta.
III. Dhoma		
Komoditeti i gjumit	21	Sipërfaqja e dhomave dopio (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 14 \text{ m}^2$ [4].
	22	Shtrat me dyshek, me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm.
	23	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m [5].
	24	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë.
	25	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla.
	26	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur.
	27	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde).
Pajisjet e dhomës	28	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura.
	29	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash.
	30	Varëse rrobash/portmanto jashtë dollapit.
	31	Një karrige.
	32	Tavolinë.
	33	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë.
	34	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës.
	35	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhome.
	36	Alarm zjarri (detektor tymi ose pajisje tjetër e ngjashme).
	37	Kosh për mbeturinat.
Kontrolli i zhurmës/ajri i kondicionuar në dhomë	38	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv.
Pajisje elektronike për argëtim	39	Pajisje TV në sallën e recepsionit, për hotelet, të cilat nuk kanë TV në çdo dhomë.
Telekomunikacioni	40	Telefon publik të disponueshëm për klientët.
Të ndryshme	41	Informacion i hotelit [6].
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	42	100% e dhomave me dush dhe WC ose vaskë dhe WC.
	43	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.) jo më pak se lartësia 1,20 m.
	44	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme).
	45	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim).
	46	Kosh për mbeturinat.
	47	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë.
	48	Mbulesë higjienike për ulësen e WC.
	49	Faqet anësore dhe dyshemeja e vaskës dhe e dushit duhet të jenë të veshura me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji.
	50	Dush me perde



	51	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë.
	52	Pasqyrë.
	53	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë grepi.
	54	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit.
	55	Sapun i pakeluar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë.
	56	Xhel për larjen e trupit në dush në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar.
	57	Shampo [7].
	58	1 peshqir të vogël për person.
	59	1 peshqir të madh për person.
Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe tualeteve në dhomë	60	Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe i tualeteve në dhomë.
	61	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve me kërkesë.
	62	Ndërrim i çarçafëve, minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri.
IV. Gastronomia		
Shërbimi i mëngjesit	63	Dhomë ngrënie për shërbimin e mëngjesit.
	64	Mëngjes bufe [8] ose menu për mëngjesin.
Shërbimi i ushqimit	65	Ofrimi i ushqimit në hotel.
Siguria ushqimore	66	Ushqimi që shërbehet në hotel, përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore dhe sipas sistemit HACCP. Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin” dhe aktet nënligjore përkatëse (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse).
Pije	67	Ofrimi pijeve në hotel.
V. Hotel Apart [9]		
Pajisjet e kuzhinës personale	68	Frigorifer
	69	Lavapjatë
	70	Një furrë dhe sobë me dy plitka
	71	Një aspirator
	72	Servis gatimi dhe ngrënie[10] për të paktën 6 persona
	73	Mjete pastrimi për të siguruar higjienën
	74	Të paktën dy peshqirë kuzhine
	75	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
VI. Kualifikimi i stafit		
Personeli	76	Të gjitha shërbimet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm [11]
	77	Hoteli ka të punësuar një personel të mjaftueshëm në numër dhe të trajnuar për të mbajtur standardet e shërbimit të parashikuara në këto kritere.
	78	I gjithë stafi trajnohet me fillimin e punësimit dhe në vazhdim sipas pozicionit.
Mjedise për personelin	79	Paraqitja, qëndrimi dhe pastërtia e personelit
	80	Dushe, tualete dhe lavamanë
	81	Dhomë çlodhjeje dhe dhomë ngrënie
	82	Dhomë fjetjeje për personelin
	83	Dhomë ndërrimi

[1] Veçanërisht, mobilimi dhe pajisjet janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura.

[2] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

[3] Tualeti është i pajisur me: pasqyrë, lavaman, kos për mbeturinat, sapun të lëngshëm, letra për duart ose pajisje për tharje të duarve, letër higjienike, varëse për rrobat, mekanizëm për mbylljen e derës, kos për mbeturinat në kabinën për femrat.

[4] Sipërfaqja minimale e dhomave teke duhet të jetë 12 m².

[5] Nuk lejohen shtretërit e mbivendosur.

[6] Përfshin të paktën informacion për orarin e mëngjesit, *check out*, dhe orarin e hapjes së shërbimeve të hotelit.

[7] Ky kriter quhet i plotësuar nëse xheli për dush është i përshtatshëm edhe si shampo dhe kjo shënohet mbi etiketën e shishes.

[8] Përfshin të paktën një pije të ngrohtë (kafe ose çaj), një lëng frutash, mundësi zgjedhjeje frutash ose sallatë frutash, mundësi zgjedhjeje buke dhe gjalpë, reçel, proshutë, djathë, vezë dhe drithëra.

[9] Nëse hoteli ofron dhoma që përfshijnë një ambient gatimi.

[10] Të tilla si: tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngrënie, filxhanë, gota etj.

[11] Për strukturat akomoduese me 4 dhe 5 yje, si dhe për strukturat me 2 dhe 3 yje, të cilat kanë më shumë se 25 dhoma, personeli duhet të jetë i veshur me uniformë.



SHTOJCA 4/e

Kriteret e detyrueshme - Motel

Fushat	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Moteli duhet të ketë të paktën 6 njësi akomoduese.
	2	Ndriçim i përshtatshëm në të gjitha ambientet (dhoma, korridore, shkallë, parkim etj.)
	3	Regjistër ku mban të dhënat për secilin nga klientët që akomodon (si: emër, mbiemër, adresa, nr. i targës dhe modeli i makinës). Gjithashtu, duhet të shënohet data dhe ora e mbërritjes dhe e largimit nga moteli.
	4	Nuk duhet t'u ofrojë akomodim personave nën 18 vjeç, përveç rasteve kur janë të shoqëruar nga prindërit apo kujdestarët e tyre.
Parkimi	5	Garazh individual ose parkim të përbashkët për çdo dhomë. Vende parkimi 100% sa nr. i dhomave plus stafin.
	6	Parkim pa pagesë
	7	Ndriçim në të gjithë sipërfaqen dhe survejim me kamera 24/7.
	8	Gjithë zona e parkimit e rrethuar.
	9	Zona e parkimit e shtruar me asfalt dhe e pajisur me sinjalistikën përkatëse.
Pastërtia dhe mirëmbajtja	10	Kanale për kullimin e ujit në zonat e parkimit.
	11	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore - kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese.
Personeli	12	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet në të gjithë ambientet e strukturës akomoduese janë funksionale dhe të padëmtuara.
	13	Të gjitha shërbimet duhet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm.
Kushtet e sigurisë	14	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe i udhëzimeve në rast zjarri.
	15	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
	16	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
Recepsioni	17	Shërbimi i pritjes (receptionit).
	18	Në hyrje njoftimi i dukshëm mbi kohën e punës.
	19	Manuali i brendshëm i procedurave dhe i stafit të hotelit në gjuhën shqipe.
	20	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishimi i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit.
	21	Regjistrimi i klientëve në një regjistër të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/ së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
	22	Kutia e ndihmës së shpejtë në reception.
	23	Vendosja e numrave të shërbimeve mjekësore dhe të urgjencës.
	24	Kasafortë qendrore në reception/facilitete të ruajtjes së sendeve me vlerë (1).
Komunikimi	25	Shkallë kryesore për vizitorët, të cilat lidhin të gjitha katet.
	26	Njësitë akomoduese të treguara me numra ose me shenja të tjera.
Pastrimi i dhomës	27	Pastrimi i përditshëm i dhomës.
	28	Ndërrim i çarçafëve, të paktën dy herë në javë dhe për çdo klient të ri.
	29	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës.
Informacion i përgjithshëm mbi dhomat	30	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 12,5 \text{ m}^2$.
	31	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 13,5 \text{ m}^2$.
Komoditeti i gjumit	32	Dyshek me teknologji bashkëkohore, i mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm.
	33	Shtretër te, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m.
	34	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë.
	35	Mbulesë/jorgan me vatinë ose me pupla.
	36	Jastëk bashkëkohor, i mirëmbajtur.
	37	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde).
	38	Rrugicë anës krevatit
Pajisjet e dhomës	39	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave.
	40	Të paktën 3 varëse rrobash për person dhe të të njëjtit material dhe model.



	41	Një karrige.
	42	Tavolinë.
	43	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë.
	44	Çelës kryesor për ndriçimin në hyrje të dhomës.
	45	Kosh për mbeturinat.
	46	Listë me çmimet e shërbimeve të motelit, minibarit (nëse ka).
	47	Televizor.
	48	Listë me çmimet e kanaleve me pagesë (nëse ka).
	49	Plani i evakuimit i vendosur mbrapa derës së dhomës.
Telekomunikacioni	50	Telefon publik të disponueshëm për klientët
	51	Akses në internet në ambientet e përbashkëta (me fishë, <i>Wi-Fi</i>) (2).
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	52	Banjoja/pajisjet sanitare $\geq 5\text{m}^2$
	53	100% e dhomave me dush dhe WC ose vaskë dhe WC me mbajtëse sigurie.
	54	Faqet anësore dhe dyshemeja e vaskës dhe dushit duhet të jenë të veshura me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji.
	55	Dush me perde/kabinë (3).
	56	Lavaman.
	57	Peshqir për këmbët në tualet.
	58	Ndriçim i përshtatshëm në lavaman.
	59	Pasqyrë.
	60	Prizë korenti e aksesueshme pranë pasqyrës.
	61	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë grepi.
	62	Raft tualeti.
	63	Gotë për furçën e dhëmbëve.
	64	Sapun njëpërdorimësh ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar.
	65	Xhel për larjen e trupit me shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar.
	66	Shampo për flokë në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar. Shampoja duhet të ketë etiketë, në mënyrë që të jetë e identifikueshme.
	67	Letër higjienike rezervë.
	68	1 peshqir duarsh për person.
	69	1 peshqir të madh për person.
	70	Pantofla njëpërdorimshme (4) sipas kërkesës.
	71	Prizë elektrike për makinën e rrojës.
	72	Kosh për mbeturina.
	73	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim).
	74	DysHEME me material kundër rrëshqitjes dhe e papërshkueshme nga uji.
	75	Mur i veshur në një lartësi deri në 1,2 m, me material të papërshkueshëm nga uji.
Mjedise për personelin	76	Dushe, tualete dhe lavamanë.
	77	Dhomë çlodhjeje dhe dhomë ngrënie.
	78	Dhomë fjetjeje për personelin.
	79	Dhomë ndërrimi

(1) Ose një kasafortë në dhomë.

(2) Ose akses në internet në dhomë.

(3) Kabina nuk duhet të ketë përmasa më të vogla se 80 x 80 cm.

(4) Pantoflat plastike nuk janë të lejueshme.



SHTOJCA 4/g

Kriteret minimale - Qendër kurative

Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që u bashkëngjitet kriterëve minimale të kategorisë “Hotel dhe resort”		
Fusha	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Sipërfaqja e qendrës kurative të paktën 3 m ² /person, sipas kapacitetit të strukturës akomoduese, duke përfshirë sipërfaqet e jashtme dhe të brendshme.
	2	Sistem alarmi dhe lidhje e recepsionit të qendrës kurative me recepsionin kryesor.
	3	Programe për trajtim shëndetësor, kura.
	4	Kontrolle të vazhdueshme të ujit, higjienës, kujdesit shëndetësor etj.
	5	Ambientet të pastra dhe të mirëmbajtura.
	6	Stafi të jetë miqësor.
	7	Zona e pritjes në recepsion e pastër dhe e rehatshme.
	8	Plotësim i një formulari përshtypjesh nga klienti përpara largimit nga qendra kurative.
Hapësira - objektet dhe pajisjet	9	Dhoma e recepsionit në qendrën kurative minimumi 25 m ² .
	10	Duhet të sigurohet një lidhje/kalim midis qendrës kurative dhe hotelit, i cili të ketë një temperaturë të përshtatshme.
	11	Recepsioni i qendrës kurative duhet të jetë i pajisur me informacione dhe listën e çmimeve.
	12	Hapësirë për stafin profesional të qendrës kurative, minimumi 10 m ² .
Hapësira të tjera dhe elementët e pritjes	13	Gardërobë për femrat me çelës, hapësirë për t'u ndërruar dhe dush, në raport me kapacitetin e qendrës kurative, një tharëse flokësh me pasqyrë, stol, karrige, peshqirë për duart dhe fytyrën, mbajtëse rrobash/peshqiri në formë horizontale ose grepi, sapun i lëngshëm.
	14	Gardërobë për meshkuj me çelës, hapësirë për t'u ndërruar dhe dush, në raport me kapacitetin e qendrës kurative, një tharëse flokësh me pasqyrë, stol, karrige, peshqir për duart dhe fytyrën, mbajtëse rrobash/peshqiri në formë horizontale ose grepi, sapun i lëngshëm.
	15	Tualet për femra në bazë të dispozitave të përgjithshme që duhen respektuar dhe në raport me kapacitetin e qendrës kurative.
	16	Tualet për meshkuj në bazë të dispozitave të përgjithshme që duhen respektuar dhe në raport me kapacitetin e qendrës kurative.
	17	Kosh për vendosjen e peshqirëve/rrobëdishanit të përdorur.
	18	Dhomë ndërimi, dush dhe tualet për stafin e qendrës kurative.
	19	Sistem alarmi në të gjitha ambientet e qendrës kurative (dush, hidromasazh, pishinë etj.) të lidhura me recepsionin e qendrës kurative ose hotelit.
	20	Hapësirë qëndrimi e shoqëruar me muzikë të lehtë relaksi.
	21	Shërbimi të ofrohet të paktën 14 orë.
	22	Ofrimi i shërbimit të telefonit për thirrje të brendshme ose të jashtme.
	23	Personel i kualifikuar në recepsion.
	24	Ofrimi i shërbimeve nga një staf i kualifikuar (si, në fizioterapi, masazhe të ndryshme ose trajtime të tjera të ngjashme).
		Ofrimi i pijeve të ndryshme për klientët me vetëshërbim.
	25	Një person përgjegjës i cili do të monitorojë dhe do të kontrollojë teknologjinë e qendrës kurative dhe do të kujdeset për shërbimet e nevojshme dhe mirëmbajtjen e qendrës kurative.
	26	Një person përgjegjës/drejtues.
	27	Të paktën 1 masazhier.
Zona e trajtimit dhe Estetika	28	Në hapësirën e qendrës kurative deri në 700 m ² , të paktën 3 dhoma për disa trajtime individuale.
	29	Në hapësirën e qendrës kurative nga 700–1500 m ² , të paktën 5 dhoma për disa trajtime individuale.
	30	Në hapësirën e qendrës kurative mbi 1500 m ² të paktën 10 dhoma për disa trajtime individuale.
	31	Të paktën 1 masazh - 3 trajtime mjekësore - 1 masazh ujqor (1).
Pajisjet e dhomës së trajtimit individual	32	Minimumi hapësirës 9 m ² .
	33	Lartësia të paktën 240 cm.
	34	Tavolinë me një lavaman (ujë të ngrohtë dhe të ftohtë), për terapistët, hapësirë për magazinimin e produkteve, p.sh., dezinfektimit, marrja e pëlhurave, bombol kundër zjarrit, kosh me kapak.
	35	Krevat për terapinë.
	36	Pajisje profesionale teknologjike për shërbimet që ofrohen (pishinë e vogël dhe e madhe,



		<i>therapeutic bath, bed wrap, scrub table, vischy shower, rasul bath etj.)</i>
	37	Dush me hapësirë për t'u ndërruar dhe për t'u vendosur rrobat përpara ose pas përfundimit të trajtimit me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë; shampo, likuid ose sapun.
	38	Hapësirë relaksi në pjesën e qendrës kurative.
	39	Set çarçafësh dhe peshqir për çdo trajtim.
	40	Ajër i kondicionuar, ventilim dhe hapësirë e ngrohtë.
	41	Mundësia e errësimit të dhomës nga drita natyrale (perde etj.).
Zona e trajtimit dhe estetika (2)	42	Të paktën 1 trajtim të kujdesit të fytyrës; 1 trajtim të kujdesit të trupit; 1 trajtim të kujdesit të duarve; 1 trajtim të kujdesit të këmbëve;
Pishinë e brendshme	43	Temperatura e ujit duhet të jetë 25–32 °C.
	44	Pishina duhet të ketë mundësi të përdoret edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 25 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative deri në 700 m ² .
	a	Të paktën një korsi për not të lirë.
	45	Pishina duhet të ketë mundësi të përdoret edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 70 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative mbi 700 m ² .
	a	Të paktën dy korsi për not të lirë.
	46	Në hapësirën e pishinës, ofrimi i dushit me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Për sipërfaqe të pishinave mbi 100 m ² , të paktën 2 dushe dhe dy vende për të vendosur peshqirë/penjuar së bashku me likuid/sapun.
	47	Person përgjegjës për monitorimin e zonës së pishinës
	48	Nëse në pishinë nuk ka pjesë për fëmijë, atëherë ajo duhet të jetë e ndarë fizikisht dhe vizualisht. Në ambientet e qendrës kurative duhet të ketë edhe një pishinë për fëmijë me lodra të ndryshme, si: rrëshqitëse uji, sauna për fëmijë, të cilat duhet të jenë nën mbikëqyrjen e stafit përgjegjës.
	49	Lartësia, të paktën 280 cm.
	50	Tabelat e rrezikut të jenë të vendosura në mure; rregullore për përdorimin e ambienteve/pajisjeve të paktën në 2 gjuhë.
Pishinë e jashtme	51	Pishina duhet të jetë edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 50 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative deri në 700 m ² .
	a	Të paktën 2 ndenjësë për pjesën e hidromasazhit.
	b	Të paktën 1 efekt për masazhin ujqor.
	52	Pishina duhet të jetë edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 100 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative mbi 700 m ² .
	a	Të paktën 4 ndenjësë për pjesën e hidromasazhit.
	b	Të paktën 2 efekte për masazhin ujqor.
	53	Ndriçimi natën i pishinës.
	54	Në hapësirën e pishinës: stola/karrige/shezlonge/ndenjësë lëkundëse (hamaca) etj., për t'u ulur.
	55	Në hapësirën e pishinës ofrimi i dushit, me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Për sipërfaqe të pishinave mbi 100 m ² , të paktën 2 dushe dhe dy vende për të vendosur peshqirë/penjuar së bashku me likuid/sapun.
	56	Kabinë/dhomë ndërrimi.
Palestër	57	Supervizim i detyrueshëm i pishinës gjatë orarit të punës.
	58	Të paktën 5 pajisje individuale.
	59	Qendrat kurative me sipërfaqe mbi 1000 m ² duhet të kenë të paktën 10 pajisje individuale
	60	Lartësia, të paktën 280 cm.
	61	Për hapësira mbi 1000 m ² , e detyrueshme një dhomë/sallë e vogël për aktivitete/ushtrime të ndryshme dhe kapacitet për 12 persona (p.sh., ushtrime tradicionale, aerobi, joga, <i>tai chi</i> , <i>reiki</i> , meditim, terapi me muzikë, ushtrime relaksuese dhe frymëmarrjeje, ushtrime të tjera në grupe të vogla etj.)
	62	Supervizor i palestrës kur ofrohen të paktën 10 pajisje individuale.
	63	Ushtrime gjimnastikore, aerobi, kërcim sportiv etj.
Shërbime shtesë të ofruara në dhomën e hotelit	64	Udhëzime për shërbimet e ofruara në zonën e qendrës kurative dhe përdorimin e pajisjeve të paktën në 1 gjuhë të huaj.
	65	Lista e shërbimeve dhe tarifave përkatëse të afishuara.
	66	Të paktën 2 programe të qendrës kurative të ofruara nga hoteli.
	67	Në banjë ose në dhomën përkatëse të ofruar nga hoteli, të ketë shampo për dush, likuid për duart, sapunë aromatikë etj.
	68	Planimetria e godinës me daljen e emergjencë e afishuar.



(1) Llojet e masazheve: Masazh klasik, masazh aromatik, masazh limfodrenues, masazh anticelulit, masazh aromaterapi, masazh *reflex*, masazh *shiatsu*, masazh antistres, masazh me gurë të ngrohtë, masazh me gurë vullkanikë, masazh me gurë të ftohtë, masazh me çokollatë dhe vanilje, masazh mineral *peeling*, masazh *royal*, masazh pinda etj.

Llojet e masazheve ujore: hidromasazh, *pearl baths*, *balneotherapy baths*, *aromatherapy baths*, *fango therapy*, *cleopatra*, *wrapping the body-packs: herbal, mud, hay* etj.

Trajtime mjekësore dhe programe rehabilitimi: Matja e pulsit, *aromaterapi*, *elektroterapi*, *phytotherapy*, *hidroterapi*, *cryotherapy*, *chiropractic*, *crystal*, *kneipp*, *chromotherapy*, *magnetic*, *naturopath*, *radial*, *dental services*, *thalasotherapy*, *yoga*, *meditation*.

Terapi në dhomë: *tepidarium*, *laconium*, *caldarium*, *sudatorium*, *oxygen therapies*, *salt water inhalation*, *medicine inhalation*, *solar*.

Trajtime elektro-fizike: teknika galvano, ultratinguj, terapi stimulimi, terapi me fushë magnetike

(2) Trajtime estetike do të përfshihen:

Trajtime për kujdesin e fytyrës: *facials*, *regenerating facial*, *deep cleansing*, *anti-aging treatments*, *treatment for rejuvenation*, *crystal faces* etj.

Trajtime për kujdesin e fytyrës: *facials*, *regenerating facial*, *deep cleansing*, *anti-aging treatments*, *treatment for rejuvenation*, *crystal faces* etj. Trajtime për kujdesin e trupit: (maskë për të gjithë trupin, trajtim anticelulit, *preventive and corrective care*, *care and skin firming treatments with healing mud*, *weight loss treatments*, *exfoliating treatments* etj.).

Trajtime për kujdesin e duarve: manikyr, zgjatim thonjsh, arti i thonjve, manikyr francez etj.

Trajtime për kujdesin e këmbëve: manikyr klasik i këmbëve, depilim i këmbëve me dyll, skrab i trupit.

SHTOJCA 4/f

Kriteret minimale - Resort

Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që u bashkëngjitet kriterëve minimale të kategorisë “Hotel”		
Fusha	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Ndërtesat duhet të jenë të shkëputura nga njëra-tjetra.
	2	Vendndodhja e resortit është në një mjedis të qetë, të shkëputur nga qyteti.
	3	Hartë orientuese e resortit në hyrje të tij.
	4	Sinjalistikë orientuese e detajuar dhe e mirëmbajtur për secilën nga godinat e resortit të pajisura me emër ose numër të veçantë.
	5	Sigurimi i hapësirave të mëdha të hapura me gjelbërim.
	6	Ofrimi i jo më pak se i dy vakteve në ambientet e restorantit.
	7	Kënd informacioni për veprimtaritë argëtuese të organizuara nga resorti (p.sh., ekskursione etj.)
Pamja e jashtme	8	Infrastruktura e lëvizjes (rrugët/rrugicat) në resort të jetë lehtësisht e përkueshme dhe në gjendje të mirë.
	9	Gjendja e ndërtesave të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe e mirëmbajtur. Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuar.
	10	Ndriçimi i ambientit të jashtëm në gjendje pune dhe në kushte të mira.
Mirëmbajtja dhe sigurimi	11	Pastrim i rregullt dhe mjedis i mirëmbajtur: pa mbeturina, gjethë etj.
	12	Shërbim i mbikëqyrjes së vazhdueshme të resortit turistik në tërësi.
	13	Facilitete të ndihmës së parë (i nevojshëm stafi i trajnuar).
Zona e pishinës	14	Pishinë e hapur, pishinë për fëmijë.
	15	Shezlonge në zonën e pishinës.
	16	Tualet dhe dush në zonën e pishinës.
	17	Ofrimi i shërbimit të barit në zonën e pishinës.
Shërbime të ofruara në resort	18	Ofrimi i 4 programeve të ndryshme argëtimi/animacion/sportive/mjedisore (1).

(1) Programe që mund të ofrohen nga resorti përfshijnë aktivitete tenisi, basketbolli, volejboli, ping-pongu, ski, kanoe, *barbeque*, koncerte, karaoke, diskotekë, bibliotekë, kënd lojërash për fëmijë, lojëra për familjen dhe fëmijët, si: *puçzle*, tavëll, domino etj., aktivitete në pishinë; ofrim i pajisjeve sportive, si biçikletë etj.



SHTOJCA 4/h

Kriteret e detyrueshme - Fjetje dhe mëngjes (B&B)

Ambienti	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi B&B		
Pastërtia/higjiena	1	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore - kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese.
Mirëmbajtja	2	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune.
Përshtypja e përgjithshme	3	Përshtypja e përgjithshme është e mjaftueshme për kërkesa mesatare (1).
Kushtet e sigurisë	4	Sistem sigurie në hyrje të strukturës akomoduese (p.sh., kamera).
	5	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe udhëzimeve në rast zjarri.
	6	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
	7	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për strukturat akomoduese (VKM nr. 699, datë 22.10.2004, “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”).
II. Recepsioni dhe shërbimet		
Zona e pritjes	8	Shërbimi i pritjes (receptionit) dhe personi në dispozicion për <i>check-in</i> , sipas një marrëveshjeje.
	9	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit, në përputhje me ligjin 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”.
	10	Regjistrim i klientëve në një regjistër të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
	11	Kutia e ndihmës së shpejtë.
	12	Afishimi i numrave të emergjencës në zonën e pritjes.
Tualetet në ambientet e përbashkëta	13	Shenja dalluese në tualete për femra dhe për meshkuj.
	14	DysHEME me material kundër rrëshqitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme).
	15	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.) jo më pak se lartësia 1.20 m.
	16	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim).
	17	Ndriçim i përshtatshëm.
	18	Lavaman me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë.
	19	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar.
	20	Letra tharëse me mbajtëse ose pajisje për tharjen e duarve.
	21	Pasqyrë.
	22	Mekanizëm për mbylljen e derës.
	23	Kosh për mbeturinat.
	24	Letër higjienike dhe mbajtëse letre.
	25	Mbulesë higjienike për ulësen e WC-së.
III. Dhoma		
Pastrimi i dhomës	26	Pastrimi i përditshëm i dhomës
	27	Ndërrim i çarçafëve një herë në javë dhe për çdo klient të ri.
	28	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës.
Informacion i përgjithshëm mbi dhomat	29	Secila dhomë të tregohet me numra ose me shenja të tjera.
	30	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 12,5 \text{ m}^2$.
	31	
Komoditeti i gjumit	32	Dyshek me teknologji bashkëkohore, i mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm.
	33	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.40 m x 1.90 m.
	34	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.90 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m.



	35	Seti i çarçafëve 100% pambuk, në ngjyrë të bardhë.
	36	Mbulesë/jorgan me vatinë ose me pupla.
	37	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur.
	38	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde).
Pajisjet e dhomës	39	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave.
	40	Të paktën 5 varëse rrobash për person të të njëjtit material dhe model.
	41	Karrige.
	42	Tavolinë.
	43	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë.
	44	Çelës kryesor për ndriçimin në hyrje të dhomës.
	45	Kosh për mbeturinat.
	46	Plani i evakuimit i vendosur mbrapa derës së çdo dhome.
	47	Alarm zjarri (detektor tymi ose pajisje tjetër e ngjashme).
Telekomunikacioni	48	Telefon publik të disponueshëm për klientët.
Të ndryshme	49	Informacion i printuar në dhomë, që përfshin të paktën orarin e mëngjesit, <i>check out</i> dhe orarin e hapjes së shërbimeve të hotelit në dy gjuhë.
	50	Material informues për rajonin, të vendosura në ambientet e përbashkëta.
Tualetet dhe pajisjet sanitare në dhomë	51	Dhomat janë me dush/vaskë dhe WC private ose të përbashkëta.
	52	Përmbushen të njëjtat kushte si për tualetet e përbashkëta, përveç letrave tharëse me mbajtëse ose pajisjes për tharjen e duarve.
	53	Faqet anësore dhe dysHEMEJA e vaskës dhe e dushit duhet të jenë të veshura, me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji.
	54	Dush me perde/kabinë (2).
	55	Peshqir për këmbët në tualet.
	56	Prizë korrenti e aksesueshme pranë pasqyrës.
	57	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë gripi.
	58	Aksesore për mbajtjen e sendeve të tualetit.
	59	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar.
	60	Xhel për larjen e trupit në dush në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar.
	61	Shampo për flokë në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar. Shampoja duhet të ketë etiketë, në mënyrë që të jetë e identifikueshme.
	62	2 peshqirë për person (1 fytire, 1 trupi).
Kuzhina/pajisjet	63	Dritare që mund të hapen ose hapësira për ventilimin me rrjeta kundër insekteve.
	64	DysHEME me material kundër rrëshqitjes dhe të papërshkueshëm nga uji.
	65	Muret e kuzhinës të veshura deri në lartësinë 2.00 m, me material që pastrohet dhe që mirëmbahet lehtësisht, i papërshkueshëm nga uji (pllaka qeramike, ose të ngjashme).
	66	Sipërfaqe pune për parapërgatitjen e ushqimeve, rafte dhe kabinete, prej materiali që nuk ndryshket (inoks) dhe jo prej druri.
	67	Kosh për mbeturinat pranë çdo sipërfaqeje pune me qese higjienike.
IV. Mëngjesi		
Shërbimi i mëngjesit	68	Dhomë ngrënie për shërbimin e mëngjesit (3).
	69	Mëngjesi shërbehet për të paktën 2 orë.
V. Teknologjia dhe sistemet e menaxhimit		
Sisteme cilësore	70	Sistem i menaxhimit të ankesave (4).
VI. Stafi		
Personeli	71	Të gjitha shërbimet duhet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm.

[1] Veçanërisht, mobilimi dhe pajisjet janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura.

[2] Kabina nuk duhet të ketë përmasa më të vogla se 80 x 80 cm.

[3] Mëngjesi përfshin të paktën një pije të ngrohtë (p.sh., kafe ose çaj), një lëng frutash, mundësi zgjedhjeje frutash, një zgjedhje buke/ëmbëlsire me galpë, reçel, proshutë, djathë, vezë dhe drithëra.

[4] Sistemi i menaxhimit të ankesave përfshin një format të plotësimit të ankesës, vlerësimin dhe përgjigjen.



URDHËR

Nr. 355, datë 16.10.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 267, DATË 24.7.2019 “MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
MËNYRËN, KRITERET DHE
PROCEDURAT E KATEGORIZIMIT TË
STRUKTURAVE AKOMODUESE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet si vijojnë:

1. Pika 4 ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:

“4. Çdo subjekt që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese është i detyruar të aplikojë për marrjen e certifikatës së kategorizimit, brenda datës 31.12.2019, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese”.

2. Paragrafi i dytë i pikës 1, të nenit 5, të rregullores bashkëlidhur urdhrit, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Formulari i vetëdeklarimit shkarkohet nga faqja zyrtare e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: turizmi.gov.al, në menunë “Turizmi/Udhëzues për qytetarët”.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

URDHËR

Nr. 582, datë 12.11.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003,, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015,, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj, nga data 13.11.2019 deri në datën 14.11.2019.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Sandër Lleshaj

KËRKESË

Nr. 6357/4, datë 28.10.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajguore.

Subjekti kërkues i shpronësimit është Bashkia Ura Vajguore.

Me anë të këtij publikimi, kërkohet që të vihet në dijeni personi i cili preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajguore, për shpronësimin e pasurisë së tij, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së



vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall” dhe për vlerësimin e pasurisë së llojit “ndërtesë”, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit (paraprake) është 51,935 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIMI URBAN DHE SISTEMIM I FSHATIT DONOFROSË,
NJËSIA ADMINISTRATIVE CUKALAT”, BASHKIA URA VAJGURORE

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i objektit	Sipërfaqe truall	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit	Vlera e truallit	Vlera e ndërtimit	Vlera e truallit dhe e ndërtësës	Shënime
					m ²	m ²	lekë/m ²	lekë	lekë	lekë	
1	Altin Flamur Metohu	1515	52/19	ndërtesë + truall	200	70	203	40,600	11,335	51,935	Llogaritjet janë kryer duke u mbështetur në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”; udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”; VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; VKM-në nr. 401, datë 23.10.1989, “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”; Çmimet e Entit Kombëtar të Banesave të miratuara me udhëzimin e KM-së nr. 3, datë 28.12.2016, aktualisht në fuqi.
VLERA TOTALE								40,600	11,335	51,935	
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT										51,935	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë